



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORI

Nr. 502 Prot.

Tiranë, më 14/05/2020

URDHËR

Nr. 43, datë 14.05.2020

PËR

**VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE TË AUTORITETEVE DHE
ORGANEVE DREJTUESE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**


Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhërit nr. 8, datë 14.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", ndryshuar, Urdhërin Nr. 108, datë 08.05.2020 "Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritete dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID – 19", si dhe Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës" miratuar me Vendimin Nr. 6, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik,

URDHËROJ:

1. Të vijohet me procedurat për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, me qëllim zhvillimin e tyre menjëherë pas përcaktimit të datave përkatëse nga Ministri i Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Andrea MALIQARI



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4 Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al